<p>2. Objektivat në fushën e efijencës së energjisë janë si në vijim:</p> <p>2.1. Largimi i barrierave për promovimin e efijencës së energjisë;</p> <p>2.2. Vënia në funksion e teknologjive me efijencë të lartë të energjisë, e sistemeve moderne të matjes dhe kontrollit, dhe sistemeve për menaxhimin e energjisë;</p> <p>2.3. Aplikimi i metodave moderne të menaxhimit të energjisë;</p> <p>2.4. Promovimi i përdorimit të pajisjeve dhe makinerisë efijente, si dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë.</p> <p>2.5. Promovimi i mekanizmave dhe instrumenteve financiare dhe ofrimi i masave stimuluese financiare dhe fiskale në përputhje me këtë ligj</p> <p>2.6. Mobilizimi i investimeve në renovim të ndërtesave.</p> <p>2.7. Bashkëpunimi mes konsumatorëve fundorë të energjisë, prodhuesve, furnizuesve të energjisë me pakicë, shpërndarësve të energjisë dhe institucioneve e autoriteteve publike, me</p>	<p>2. The objectives in the field of energy efficiency are as follows:</p> <p>2.1. Removing barriers to promoting energy efficiency;</p> <p>2.2. Introducing highly energy-efficient technologies, modern measurement and control systems, and energy management systems;</p> <p>2.3. Application of modern energy management principles;</p> <p>2.4 Promoting the use of energy-efficient equipment and machinery, as well as renewable energy sources.</p> <p>2.5 Promoting financial mechanisms and instruments, and granting financial and fiscal incentives for energy efficiency, in accordance with this law;</p> <p>2.6 Mobilization of investments in renovation of buildings.</p> <p>2.7 Cooperation between final customers, producers, retail energy suppliers, energy distributors and public entities, in order to achieve the national energy efficiency policy objectives.</p>	<p>2. Ciljevi u oblasti energetske efikasnosti su sledeći:</p> <p>2.1. Uklanjanje prepreka za promovisanje energetske efikasnosti;</p> <p>2.2. Stavljanje u funkciju tehnologija visoke energetske efikasnosti, modernih sistema merenja i kontrole i sistema energetskeg menadžmenta;</p> <p>2.3. Primena modernih metoda energetskeg menadžmenta.</p> <p>2.4. Promovisanje korišćenja efikasnih uređaja i mašina, kao i obnovljivih izvora energije;</p> <p>2.5. Promovisanje finansijskih mehanizama i instrumenata i pružanje stimulatvinih finansijskih i fiskalnih mera, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2.6. Mobilizacija investicija u renoviranje zgrada.</p> <p>2.7. Saradnja između krajnih potrošača energije, proizvođača, snabdevača na malo energijom, distributora energije i javnih institucija i organa u cilju postizanja nacionalnih ciljeva politika za</p>
---	--	---

<p>qëllim të arritjes së objektivave kombëtare të politikave për eficiencën e energjisë.</p> <p>2.8. Sigurimi i auditimeve energjetike të cilësisë së lartë, sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe shërbimeve energjetike në treg.</p> <p>2.9. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së konsumatorëve të energjisë mbi rëndësinë dhe përfitimet nga zbatimi i masave për ngritje të eficiencës së energjisë;</p> <p>2.10. Promovimi i hulumtimeve themelore dhe aplikative në fushën e eficiencës së energjisë.</p>	<p>2.8 Ensuring availability of high quality energy audits, energy management systems and energy services in the market.</p> <p>2.9 Educating and raising awareness of energy consumers on the importance and benefits of implementing measures to increase energy efficiency.</p> <p>2.10. Promoting fundamental and applicative research in the field of energy efficiency.</p>	<p>energetsku efikasnost.</p> <p>2.8. Obezbeđivanje visokokvalitetnih energetske revizija, sistema energetske menadžmenta i energetske usluga na tržištu.</p> <p>2.9. Edukacija i podizanje svesti potrošača energije o značaju i koristenju od sprovođenja mera za povećanje energetske efikasnosti.</p> <p>2.10. Promovisanje osnovnih i aplikativnih istraživanja u oblasti energetske efikasnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe Raporti Vjetor i Progresit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>National Energy Efficiency Action Plan and Annual Progress Report</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Nacionalni akcioni plan za energetsku efikasnost i godišnji izveštaj o napretku</b></p>
<p>1. Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) përcakton dhe përshkruan veprimet për arritjen e objektivave të politikës shtetërore në fushën e eficiencës së energjisë, duke përfshirë skemën e detyrimeve të eficiencës së energjisë, masat e politikave të eficiencës së energjisë, kursimet e energjisë të arritura ose të parashikuara për t'u arritur në nivel të furnizimit, transmisionit, shpërndarjes</p>	<p>1. The National Energy Efficiency Action Plan (NEEAP) establishes and describes the actions to achieve the State policy objectives in the field of energy efficiency, including the energy efficiency obligation scheme, energy efficiency policy measures, energy savings achieved or envisaged to be achieved on the level of supply, transmission, distribution and final energy consumption, with a view to</p>	<p>1. Nacionalni akcioni plan za energetsku efikasnost (NAPEE) uvodi i opisuje radnje za postizanje ciljeva državne politike u polju energetske efikasnosti, uključujući sheme obavezne energetske efikasnosti, mere politika za energetsku efikasnost, postignutu ili predviđenu uštedu energije na nivou snabdevanja, prenosa, distribucije i krajnje energetske potrošnje, u smislu postizanja</p>

<p>dhe konsumit final të energjisë, me qëllim që të përmbushen caqet kombëtare të efijencës së energjisë.</p> <p>2. Duke filluar nga data 30 qershor 2019 për çdo tri (3) vite në vijim, AKEE në bashkëpunim me palët e tjera përgjegjëse, rishikon PKVEE të cilin ia dërgon Ministrisë për shqyrtim dhe procedim të mëtejme te Qeveria e Kosovës për miratim. Plani përfshin caqet trivjeçare të EE.</p> <p>3. Pas miratimit nga Qeveria, PKVEE publikohet në web-faqen zyrtare të Ministrisë dhe i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë jo më vonë se deri më 31 dhjetor të vitit përkatës.</p> <p>4. PKVEE i rishikuar përfshin edhe raportin e progresit për planin paraprak tre (3)vjeçar të EE, duke përfshirë plotësimin e caqeve të këtij plani.</p> <p>5. PKVEE përfshin një vlerësim dhe, sipas nevojës, barrierat rregullative dhe jorregullative për efijencë të energjisë, si dhe të parasheh masat për largimin e tyre, përfshirë masat që ofrojnë stimulim, shfuqizojnë apo ndryshojnë dispozita ligjore apo rregullative, miratojnë udhëzime dhe ose thjeshtësojnë procedura administrative.</p>	<p>achieving the national energy efficiency targets.</p> <p>2. Starting from 30 June 2019 and every three (3) years thereafter, the KEEA, in close cooperation with other responsible parties, shall prepare and submit the NEEAP to the Ministry for consideration and further proceeding to the Government of Kosovo for approval. The plan shall contain three-year EE targets.</p> <p>3. After the approval by the Government, the NEEAP shall be published on the official website of the Ministry and shall be submitted to the Secretariat of the Energy Community no later than 31 December of the respective year.</p> <p>4. The NEEAP shall include a progress report of the previous three (3) years plan on EE, including fulfillment of the EE targets of this plan.</p> <p>5. NEEAP shall include an evaluation and, if necessary, regulatory and non-regulatory barriers to energy efficiency, and foresee appropriate measures to remove them, including measures providing of incentives, repealing or amending legal or regulatory provisions, adopting guidelines and or simplifying administrative procedures.</p>	<p>ciljeva nacionalne energetske efikasnosti</p> <p>2. Počev od 30 juna 2019 godine, u svakoj od tri (3) naredne godine, KAEE u saradnji sa drugim nadležnim stranama, preispituje NAPEE i dostavlja Ministarstvu na razmatranje i dalje prosleđivanje Vladi Kosova na usvajanje. Plan sadrži trogodišnje ciljeve EE.</p> <p>3. Nakon usvajanja od strane Vlade, NAPEE se objavljuje na zvaničnom sajtu Ministarstva i ga upućuje Sekretarijatu Energetske Zajednice najkasnije do 31 Decembra odnosne godine.</p> <p>4. Preispitani NAPEE sadrži i izveštaj o napretku za prethodni tro (3)godišnji plan za EE, uključujući i ispunjenje ciljeva ovog plana.</p> <p>5. NAPEE sadrži procenu i, po potrebi, regulatorne i neregulatorne barijere za energetske efikasnost, te predviđa mere za njihovo otklanjanje, uključujući i mere kojima se pruža podsticaj, stavljaju van snage ili menjaju zakonske ili regulatorne odredbe, usvajaju smernice i ili pojednostavljaju administrativne procedure.</p>
--	--	---

<p>6. Ministria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kornizës së përgjithshme për NEEAP duke përfshirë kërkesat e raportimit të parashikuara për Planet Kombëtare të Veprimit për Eficiencë të Energjisë.</p> <p>7. Në baza vjetore, më 30 qershor të çdo viti, AKEE përgatit raportin e progresit mbi përparimin në raportimin e caqeve vjetore të eficiencës së energjisë, në pajtim me aktin nënligjor të përcaktuar në paragrafi 1.13 të nenit 42 të këtij ligji. Platforma e monitorimit dhe verifikimit (PMV) do të përdoret, kur është e mundur, në llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe raportimit mbi masat e PKVEE. Raporti i dorëzohet Qeverisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.</p> <p>8. Në mënyrë që të krahasohen kursimet e energjisë dhe të kryhet konvertimi në një njësi krahasuese, faktorët e konvertimit do të definohen në aktin nënligjor siç përcaktohet në paragrafi 1.4 të nenit 42 të këtij ligji.</p> <p>9. Çdo vit, deri më 30 Prill, të gjitha palët përgjegjëse sipas PKVEE janë të obliguara të raportojnë te AKEE për zbatimin e aktiviteteve të tyre të parapara në PKVEE.</p>	<p>6. The Ministry shall issue secondary legislation determining the general NEEAP framework, including requirements for reporting on National Energy Efficiency Action Plans.</p> <p>7. On annual basis, on June 30 of each year, KEEA, shall prepare a progress report on the achievement of national energy efficiency targets, in accordance with the secondary legislation referred to in paragraph 1.13 of article 42 of this law. The Monitoring and Verification Platform (MVP) shall be used when possible in calculating the energy savings and reporting on measures from NEEAP. The report is submitted to the Government and the Energy Community Secretariat.</p> <p>8. In order to compare energy savings and perform the conversion into a comparable unit, the conversion factors will be defined in secondary legislation provided to in paragraph 1.4 of article 42 of this law.</p> <p>9. Each year, by April 30, all parties having responsibilities under the NEEAP are obliged to report to the KEEA on implementation of their activities foreseen in the NEEAP.</p>	<p>6. Ministarstvo donosi podzakonske akte za utvrđivanje celokupnog okvira za NAPEE, uključujući i zahteve za izveštavanje predviđene za nacionalne akcione planove za energetske efikasnost.</p> <p>7. Na godišnjoj osnovi, 30. juna svake godine, KAEE priprema izveštaj o napretku u izveštavanju o godišnjim ciljevima energetske efikasnosti, u skladu sa sekundarnim zakonodavstvom koje je navedeno u stav 1.13 člana 42 ovog zakona. Platforma nadgledanja i provere (MNV) će biti korišćena kada god je moguće prilikom obračuna energetske uštede i izveštavanja o merama iz NAPEE-a. Izveštaj se dostavlja Vladi i Sekretarijatu Energetske zajednice.</p> <p>8. Da bi se uporedila ušteda energije i izvršila konverzija u uporedivu jedinicu, faktori konverzije će biti definisani u sekundarnom zakonodavstvu koje je utvrđeno u stav 1.4 člana 42 ovog Zakona.</p> <p>9. Svake godine, do 30 Aprila, sve strane koje su odgovorne prema NAPEE dužne su da izveste KAEE o sprovođenju svojih aktivnosti predviđenih u NAPEE.</p>
---	--	--

<p align="center"><b>Neni 6</b> <b>Planet Komonale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, zbatimi dhe raportimi</b></p>	<p align="center"><b>Article 6</b> <b>Municipal Energy Efficiency Action Plans, implementation and reporting</b></p>	<p align="center"><b>Član 6</b> <b>Opštinski akcioni planovi za energetske efikasnost, sprovođenje i izveštavanje</b></p>
<p>1. Duke filluar nga 15 maji i vitit 2018 për çdo tri (3) vite, komunat përgatisin dhe dorëzojnë në AKEE draft-planet komunale të veprimit për eficiencë të energjisë, të cilat do të përfshijnë politikat e propozuara të eficiencës së energjisë dhe masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë, të cilat mbulojnë të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel komunal.</p> <p>2. Para miratimit të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal, AKEE do të vlerësojë përputhshmërinë e tij me politikat kombëtare të eficiencës së energjisë, caqet dhe planet përkatëse dhe ta japë opinionin me rekomandime, brenda 60 ditësh nga data e parashtrimit të draft-planit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Miratimi i Planeve Komonale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal duhet të bëhet para datës 30 nëntor të vitit përkatës dhe i njëjti duhet të mbulojë tri (3) vitet në vijim.</p> <p>3. Plani, veç tjerash, parashikon krijimin dhe funksionimin e sistemeve komunale të menaxhimit të energjisë dhe monitorimit, sipas rastit, sistemeve individuale të menaxhimit të energjisë, duke përfshirë</p>	<p>1. Starting from 15 May 2018 and every three (3) years, municipalities shall prepare and submit to KEEA draft Municipal Energy Efficiency Action Plans that shall include proposed energy efficiency policy and energy efficiency improvement measures covering all sectors operating at the municipal level.</p> <p>2. Prior to the adoption of the Municipal Energy Efficiency Action Plan by the Municipal Assembly, the KEEA shall evaluate their compliance with the national energy efficiency policies, targets and plans and present its opinion with recommendations, within 60 days from the submission of the draft Plan as per paragraph 1 of this article. Adoption of the Municipal Energy Efficiency Action Plans by Municipal Assemblies shall be done no later than 30 November of the respective year, and shall cover the upcoming next 3(three) years.</p> <p>3. The Plan shall, among other, envisage the establishment and operation of municipal energy management and monitoring system and, where appropriate, individual energy management systems, including energy</p>	<p>1. Počev od 15. maja 2018. godine, svake treće (3) godine, opštine će pripremati i dostaviti KAEE nacрте opštinskih akcionih planova za energetske efikasnost, koji će sadržavati predložene politike energetske efikasnosti i mere za poboljšanje energetske efikasnosti, koje pokrivaju sve sektore koji funkcionišu na opštinskom nivou.</p> <p>2. Pre usvajanja opštinskog akcionog plana za energetske efikasnost od strane Skupštine opštine, KAEE će proceniti njegovu usklađenost sa nacionalnim politikama energetske efikasnosti, ciljevima i relevantnim planovima i dostaviti svoje mišljenje sa preporukama u roku od 60 dana od dana dostavljanja nacрта plana iz stava 1 ovog člana. Skupštine opštine moraju usvojiti nacionalne akcione planove za energetske efikasnost pre 30. novembra odnosne godine i isti moraju pokrivati naredne tri (3) godine.</p> <p>3. Plan, između ostalog, predviđa uspostavljanje i funkcionisanje opštinskih sistema energetske menadžmenta i praćenja, po potrebi, individualnih sistema energetske menadžmenta, uključujući energetske revizije</p>

<p>auditimin e energjisë për ndërtesat që konsumojnë energji të mëdha dhe ose kompanitë komunale, si dhe për renovimin e ndërtesave publike për të përmbushur standardet minimale të performancës së energjisë të përcaktuara me Ligjin për Performancën e Energjisë në Ndërtesa, dhe masat e tjera të efijencës së energjisë të ndërmarra në objektet nën kontrollin e komunave.</p> <p>4. Me qëllim të zbatimit të sistemit komunal të menaxhimit të energjisë, komunat funksionalizojnë zyrat komunale të energjisë me personel të kualifikuar për menaxhimin e energjisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Çdo vit dhe jo më vonë se data 30 prill, Kuvendi Komunal miraton dhe ia dorëzon AKEE raportin e progresit për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Efijencën e Energjisë për vitin paraprak. Komunat duhet të përdorin platformën e veçantë të softuerit dhe ose faqen e të dhënave për raportim. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit sigurohet nga AKEE.</p> <p>6. Brenda 60 ditësh nga pranimi i raportit, sipas paragrafit 5 të këtij neni, AKEE vlerëson progresin e arritur, vlerëson nevojat dhe propozon masat përmirësuese apo të tjera</p>	<p>auditing for large energy consuming buildings and/or municipal companies, as well as for renovation of public buildings to meet the minimum energy performance standards set by the Law on Energy Performance of Buildings, and other energy efficiency measures undertaken in facilities under the control of municipalities.</p> <p>4. For the purpose of implementing the municipal energy management system, the municipalities will be functionalizing the municipal energy offices with personnel qualified to perform energy management, in accordance with the legislation in force .</p> <p>5. Annually, and no later than 30 April, the Municipal Assembly shall approve and submit to KEEA the Progress Report on the implementation of Municipal Energy Efficiency Action Plan for the previous year. Municipalities shall use the specific software and or web-based platform for reporting. The Monitoring and Verification Platform shall be provided by KEEA.</p> <p>6. Within 60 days from receiving the report according to paragraph 5 of this article, KEEA shall evaluate the progress achieved, assess the needs and propose remedial measures or other</p>	<p>za zgrade koje troše mnogo energije i/ili komunalna preduzeća, kao i renoviranje javnih zgrada u cilju ispunjenja minimalnih standarda energetske učinka, utvrđenih Zakonom o energetske učinku u zgradama, i drugim merama energetske efikasnosti preduzetim u objektima pod kontrolom opština.</p> <p>4. U cilju implementacije opštinskog sistema energetske menadžmenta, opštine funkcionalizuju opštinske kancelarije za energiju sa osobljem koje je kvalifikovano za energetske menadžment u skladu sa važećim zakonom.</p> <p>5. Svake godine, najkasnije do 30. aprila, Skupština opštine usvaja i podnosi KAEE izveštaj o napretku u sprovođenju opštinskog akcionog plana za energetske efikasnost za prethodnu godinu. Opštine mora da koriste posebnu softversku platformu i ili stranicu sa podacima za izveštavanje. Platformu za praćenje i verifikaciju obezbeđuje KAEE.</p> <p>6. U roku od 60 dana od dana prijema izveštaja prema stavu 5 ovog člana, KAEE ocenjuje postignuti napredak, procenjuje potrebe i predlaže korektivne ili druge mere</p>
---	--	---

<p>për zbatimin e PKVEE në nivel lokal. Në bazë të vërejtjeve të AKEE, Komunitat ndryshojnë, nëse kërkohet, Planin Komunal të Veprimit për periudhën e mbetur për zbatim, jo më vonë se deri më 30 Nëntor të vitit përkatës.</p> <p>7. Ministria nxjerr një model për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe formën dhe përmbajtjen e Raportit të Progresit për Zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p>8. Komunitat monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e qasësive të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, komunitat duhet të krijojnë dhe menaxhojnë një sistem informacioni për mbledhjen e të dhënave për konsumin e energjisë në ndërtesat komunale dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, duke përdorur platformën e bazuar në faqen zyrtare elektronike për raportim, Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP).</p> <p>9. Komunitat do të promovojnë në nivel lokal politikën kombëtare për eficiencë të energjisë, dhe do t'i informojnë qytetarët mbi përfitimet nga masat për ngritje të eficiencës së energjisë dhe mënyrën e realizimit të tyre.</p>	<p>measures for the implementation of the NEEAP at local level. On the basis of the remarks by KEEA, if required, Municipalities shall amend, the Municipal Action Plan for the remainder of its implementation, no later than 30 November of the respective year.</p> <p>7. The Ministry shall issue a template to define the form and content of the Municipal Energy Efficiency Action Plan and the form and content of the Progress Report on the Implementation of the Municipal Energy Efficiency Action Plan, no later than six (6) months after the entry into force of the this law.</p> <p>8. Municipalities shall monitor regularly the implementation of the plan and the achievement of the targets for energy savings. To this scope, municipalities shall create and manage an information system for collecting data on energy consumption in municipal buildings, and monitor the savings resulted from implementation of measures in public buildings, using the web-based platform for reporting, Monitoring and Verification Platform(MVP).</p> <p>9. Municipalities shall promote national energy efficiency policies at the local level and inform citizens of the benefits and manner of implementation of energy efficiency improvement measures.</p>	<p>za sprovođenje NAPEE na lokalnom nivou. Na osnovu primedbi KAEE, opštine će izmeniti, ako je potrebno, opštinski akcioni plan za preostali period za sprovođenje, najkasnije do 30 Novembra odnosno godine.</p> <p>7. Ministarstvo će objaviti šablon za definisanje oblika i sadržaja Opštinskog akcionog plana za energetske efikasnost i oblika i sadržaja Izveštaja o napretku u sprovođenju Opštinskog akcionog plana za energetske efikasnost ne kasnije od šest(6) meseci od stupanja na snagu ovog zakona.</p> <p>8. Opštine redovno prate sprovođenje plana i postizanje ciljeva uštede energije. U tu svrhu, opštine će uspostaviti i upravljati informacionim sistemom za prikupljanje podataka o potrošnji energije u opštinskim zgradama i nadgledati uštede koje su postignute sprovođenjem mera u javnim zgradama, koristeći platformu zasnovanu na web-u za izveštavanje ( MVP).</p> <p>9. Opštine će na lokalnom nivou promovisati nacionalne politike za energetske efikasnost i informisati građane o koristima od mera za poboljšanje energetske efikasnosti i načinima za njihovo ostvarivanje.</p>
---	---	---



<p>10. Komunat, si dhe institucionet tjera publike në nivel lokal dhe qendror, shfrytëzojnë, kurdo që kjo është e mundshme, kompanitë e shërbimeve energjetike dhe kontraktimin e performancës energjetike për renovime dhe implementim të planeve për të përmirësuar eficiencën e energjisë në aspektin afatgjatë.</p> <p><b>KAPITULLI III EFIÇIENCA NË PËRDORIMIN E ENERGIJISË</b></p> <p><b>Neni 7 Strategjia për rinovimin e ndërtesave</b></p> <p>1. Ministria, e mbështetur nga AKEE dhe në bashkëpunim me ministritë e linjës përgjegjëse për ndërtime dhe apo administrim të ndërtesave, zhvillon Strategjinë afatgjate për mobilizimin e investimeve për rinovime të ndërtesave të banimit dhe atyre komerciale, publike dhe private. Ministria dorëzon Draftin e Strategjisë në Qeveri për aprovim jo më vonë se 30 qershor 2018, si dokument të veçantë. Strategjia duhet të përfshijë si në vijim:</p> <p>1.1 një pasqyrë të stokut të ndërtesave në nivel vendi bazuar në të dhënat statistikore dhe ose një mostër, sipas nevojës, të kategorive të ndërtesave;</p>	<p>10. Municipalities, as well as other public institutions at local and central level, shall use, where appropriate, energy service companies, and energy performance contracting to finance renovations and implement plans to improve energy efficiency in the long term.</p> <p><b>CHAPTER III EFFICIENCY IN ENERGY USE</b></p> <p><b>Article 7 Building renovation strategy</b></p> <p>1. The Ministry, supported by KEEA, and in collaboration with the line Ministries responsible for construction and or administration of buildings, shall develop a long-term Strategy for mobilizing investments in the renovation of the residential and commercial buildings, both public and private. The Ministry shall submit the Draft Strategy to the Government for approval no later than 30 June 2018, a separate document. The Strategy shall encompass at least the following:</p> <p>1.1 an overview of the national building stock based on statistical data and or sampling, as appropriate, per category of buildings;</p>	<p>10. Opštine, kao i druge javne institucije na lokalnom i centralnom nivou, koriste, kad god je moguće, preduzeća za energetske usluge i ugovaranje energetske učinka za obnovu i sprovođenje planova za poboljšanje energetske efikasnosti u dugoročnom pogledu.</p> <p><b>POGLAVLJE III EFIKASNOST U KORIŠĆENJU ENERGIJE</b></p> <p><b>Član 7 Strategija za obnovu zgrada</b></p> <p>1. Ministarstvo, uz podršku KAEE i u saradnji sa resornim ministarstvima nadležnim za izgradnju i ili upravljanje zgradama, izrađuje dugoročnu strategiju za mobilizaciju investicija za renoviranje javnih i privatnih stambenih i poslovnih zgrada. Ministarstvo dostavlja Nacrt Strategije Vladi na usvajanje najkasnije do 30. juna 2018. godine, kao poseban dokument. Strategija će sadržavati sledeće:</p> <p>1.1 pregled fonda zgrada na nivou zemlje zasnovano na statističkim podacima i/ili uzorak, po potrebi, kategorija zgrada;</p>
---	--	--

<p>1.2 identifikimi i qasjeve kost-efektive për rinovimet që lidhen me llojin e ndërtesave dhe zonën klimatike;</p> <p>1.3 politikat dhe masat për stimulimin e rinovimeve të thella kost-efektive të ndërtesave duke përfshirë rinovimet e thella në faza;</p> <p>1.4 një perspektivë të ardhshme që jep udhëzim të investimeve të individëve, industrisë së ndërtimit dhe institucioneve financiare;</p> <p>1.5 një vlerësim të bazuar në dëshmi të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera.</p> <p>2. Strategjia do të marrë parasysh caqet e eficiencës së energjisë sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, si dhe aspektet sociale që mund të kontribuojnë në zbutjen e varfërisë energjetike.</p> <p>3. Pas miratimit nga Qeveria, Strategjia publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë. Strategjia do të përditësohet çdo tri (3) vite dhe do të dorëzohet në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.</p>	<p>1.2 identification of cost-effective approaches to renovations relevant to the building type and climatic zone;</p> <p>1.3 policies and measures to stimulate cost-effective deep renovations of buildings, including staged deep renovations;</p> <p>1.4 a forward-looking perspective to guide investment decisions of individuals, the construction industry and financial institutions;</p> <p>1.5 an evidence-based estimate of expected energy savings and wider benefits.</p> <p>2. The Strategy shall take into account energy efficiency targets under the National Energy Efficiency Action Plan, as well as social aspects that can contribute to alleviation of energy poverty.</p> <p>3. After the approval by the Government, the Strategy shall be published in the official website of the Ministry. The Strategy shall be updated every three (3) years thereafter and submitted to the Energy Community Secretariat.</p>	<p>1.2 identifikaciju troškovno efikasnih pristupa za renoviranje koji se odnose na vrstu zgrada i klimatsku zonu;</p> <p>1.3 politike i mere za podsticanje značajnih troškovno efikasnih renoviranja zgrada, uključujući značajna renoviranja po fazama;</p> <p>1.4 buduću perspektivu koja pruža investicione smernice pojedincima, građevinskoj industriji i finansijskim institucijama;</p> <p>1.5 procenu zasnovanu na dokazima o očekivanoj uštedi energije i širim koristima.</p> <p>2. Strategija će uzeti u obzir ciljeve energetske efikasnosti iz Nacionalnog akcionog plana za energetske efikasnost, kao i socijalne aspekte koji mogu doprineti ublažavanju energetskog siromaštva.</p> <p>3. Nakon usvajanja u Vladi, Strategija će biti objavljena na zvaničnoj stranici Ministarstva. Strategija će biti ažurirana svake tri (3) godine nakon toga i podneta Sekretarijatu Energetske Zajednice.</p>
--	---	--

<p align="center"><b>Neni 8</b> <b>Renovimi i ndërtesave publike</b></p>	<p align="center"><b>Article 8</b> <b>Renovation of public buildings</b></p>	<p align="center"><b>Član 8</b> <b>Renoviranje javnih zgrada</b></p>
<p>1. Për ta demonstruar rolin shembullor të organeve publike në performancën energjetike të ndërtesave, Qeveria e Republikës së Kosovës rinovon 1% të sipërfaqes totale të kateve të ndërtesave me ngrohje dhe ose me ftohje në pronësi dhe shfrytëzim nga institucionet qeveritare të nivelit qendror, çdo vit, për të përmbushur së paku kërkesat minimale për performancën e energjisë në pajtim me Ligjin për Performancën e Energjisë në ndërtesa.</p> <p>2. Shkalla e renovimit prej 1% do të llogaritet nga data 1 dhjetor 2017 dhe llogaritet në sipërfaqen e përgjithshme të ndërtesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 500 m<sup>2</sup> që në 1 janar të çdo viti, nuk i përmbushin kërkesat kombëtare të performancës minimale të energjisë sipas Ligji mbi Performancën e Energjisë në ndërtesa. Ky prag duhet të ulet në 250 m<sup>2</sup> nga 1 janari 2019 .</p> <p>3. Gjatë zbatimit të masave për renovimin gjithëpërfshirës të ndërtesave të qeverisë qendrore në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të merret parasysh ndërtesa në tërësi, duke përfshirë mbulojën, pajisjet, funksionimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës.</p>	<p>1. To demonstrate the exemplary role of the public bodies in energy performance of buildings, each year the Government of the Republic of Kosovo shall renovate 1% of the total floor area of heated and/or cooled buildings owned and occupied by the central government institutions to meet at least the minimum energy performance requirements in accordance with the Law on Energy Performance of buildings.</p> <p>2. The 1% renovation rate shall count from 1st December 2017 and shall be calculated on the total floor area of buildings with a total useful floor area over 500 m<sup>2</sup> that, on 1 January of each year do not meet the national minimum energy performance requirements according to the Law on Energy Performance of buildings. That threshold shall be lowered to 250 m<sup>2</sup> as of 1 January 2019.</p> <p>3. When implementing measures for the comprehensive renovation of central government buildings in accordance with the paragraph 1 of this article, the building as a whole, including the building envelope, equipment, operation and maintenance shall be considered.</p>	<p>1. Kako bi se demonstrirala uzorna uloga javnih organa u energetskom učinku zgrada, Vlada Republike Kosovo renovira 1% ukupne površine spratova zgrada sa grejanjem i/ili hlađenjem u vlasništvu i na korišćenju od strane centralne vlade, svake godine, radi ispunjenja najmanje minimalnih zahteva za energetski učinak u skladu sa Zakonom o energetskom učinku u zgradama.</p> <p>2. Stopa renoviranja od 1% izračunava se počev od 1. decembra 2017. godine i izračunava se na osnovu ukupne površine zgrada čija ukupna korisna površina veća od 500 m<sup>2</sup> koje, na dan 1. januara svake godine, ne ispunjavaju nacionalne zahteve za minimalni energetski učinak u skladu sa Zakonom o energetskom učinku u zgradama. Ovaj prag od 1 januara 2019 godine treba smanjiti na 250 m<sup>2</sup>.</p> <p>3. Pri sprovođenju mera za sveobuhvatno renoviranje zgrada centralne vlade u skladu sa stavom 1 ovog člana, treba razmotriti zgradu u celini, uključujući omotač, opremu, funkcionisanje i održavanje zgrade.</p>

<p>4. Kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për kategoritë vijuese të ndërtesave:</p> <p>4.1 ndërtesat që janë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe nëse përmbushja e kërkesave minimale të performancës së energjisë do të ndryshonte karakterin ose paraqitjen e tyre në mënyrë të papranueshme;</p> <p>4.2 ndërtesat në pronësi të forcave të armatosura ose qeverisë qendrore dhe që i shërbejnë qëllimeve të mbrojtjes kombëtare, përveç banesave individuale të banimit ose ndërtesave të zyrave për forcat e armatosura dhe stafin tjetër të punësuar nga autoritetet kombëtare të mbrojtjes;</p> <p>4.3. ndërtesat që përdoren si objektet e kultit dhe ato për aktivitete fetare.</p> <p>5. Nëse gjatë një viti ndërtesat e renovuara të sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni tejkalojnë shkallën prej 1%, kjo mund të llogaritet drejt normës vjetore të renovimit të cilësdo nga tri (3) vitet e mëparshme ose pasardhëse.</p> <p>6. Ndërtesat e reja të shfrytëzuara dhe në pronësi si zëvendësime për objekte specifike</p>	<p>4. Requirements set out in paragraphs 1 and 2 of this Article shall not apply to the following categories of buildings:</p> <p>4.1 buildings which are part of the national cultural heritage and where compliance with certain minimum energy performance requirements would alter their character or appearance in an unacceptable manner;</p> <p>4.2 buildings owned by the armed forces or central government and serving national defense purposes, apart from single living quarters or office buildings for the armed forces and other staff employed by national defense authorities;</p> <p>4.3 buildings used as places of worship and for religious activities.</p> <p>5. If during one year the renovated buildings referenced to in paragraphs 1 and 2 of this article exceed the 1% rate, this can count towards the annual renovation rate of any of the three(3) previous or following years.</p> <p>6. New buildings occupied and owned as replacements for specific central government</p>	<p>4. Zahtevi utvrđeni u stavovima 1 i 2 ovog člana ne primenjuju se na sledeće kategorije zgrada:</p> <p>4.1 zgrade koje su deo nacionalne kulturne baštine i ako bi ispunjenje minimalnih zahteva energetskeg učinka na neprihvatljiv način promenilo njihov karakter ili izgled;</p> <p>4.2 zgrade koje su u vlasništvu oružanih snaga ili centralne vlade i koje služe ciljevima nacionalne odbrane, osim pojedinačnih prostora za stanovanje ili kancelarijskih zgrada za oružane snage i drugo osoblje koje zapošljavaju nacionalni organi za odbranu;</p> <p>4.3. zgrade koje se koriste kao objekti za obrede i verske aktivnosti.</p> <p>5. Ako tokom godine renovirane zgrade navedene u stavovima 1 i 2 ovog člana premaše stopu od 1%, ovo se može uračunati u godišnju stopu renoviranja bilo koje od prethodne ili sledeće tri (3) godine.</p> <p>6. Nove zgrade koje su u upotrebi ili u vlasništvu kao zamena za određene objekte</p>
--	---	---

<p>të qeverisë qendrore të demoluara në cilindo nga dy (2) vitet e mëparshme, ose ndërtesat që janë shitur, demoluar ose larguar nga përdorimi në cilindo nga dy vitet paraprake si pasojë e përdorimit më intensiv të ndërtesave të tjera mund të llogariten drejt normës vjetore të renovimit.</p> <p>7. Deri më 31 Korrik 2018, AKEE, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e ndërtesave publike, përgatit dhe do të bëjë publik një inventar të ndërtesave të institucioneve qeveritare të nivelit qendror nga paragrafi 2 i këtij neni duke mos përfshirë ndërtesat nga paragrafi 4 i këtij neni. Ky inventar duhet të përmbajë së paku të dhënat si në vijim:</p> <p>7.1. sipërfaqen e dyshemesë në m2; dhe</p> <p>7.2. performancën e energjisë të çdo ndërtese ose të dhënat përkatëse të energjisë.</p> <p>8. Ministria, e mbështetur nga AKEE dhe FKEE, përgatit dhe dorëzon për miratim në Qeveri, akte nënligjore për Planin tre(3) vjeçar të renovimit për ndërtesat e qeverisë qendrore që do të përcaktojnë së paku:</p> <p>8.1. listën e ndërtesave në pronësi dhe të shfrytëzuara nga qeveria qendrore që do të renovohen çdo vit, masat kryesore të efijencës së energjisë dhe</p>	<p>buildings demolished in any of the two previous years, or buildings that have been sold, demolished or taken out of use in any of the two (2) previous years due to more intensive use of other buildings can count towards the annual renovation rate.</p> <p>7. By 31 July 2018, KEEA, in collaboration with the line Ministry responsible for management of public buildings, shall prepare and make publicly available an inventory of central government buildings referred to in paragraph 2 of this article, and shall exclude buildings referred to in paragraph 4 of this article. This inventory shall at least contain the following data:</p> <p>7.1 the floor area in m2; and</p> <p>7.2 the energy performance of each building or relevant energy data.</p> <p>8. The Ministry, supported by KEEA and KEEF, shall prepare and submit to the Government for approval secondary legislation on the three (3)year renovation plan central government buildings that shall define, at least:</p> <p>8.1 the list of buildings owned and occupied by the central government to be renovated each year, the main energy efficiency measures and estimated</p>	<p>centralne vlasti koje su demolirane tokom bilo koje od prethodne dve godine ili zgrade koje su prodate, demolirane ili stavljene van upotrebe tokom bilo koje od dve (2) prethodne godine kao posledica intenzivnije upotrebe drugih zgrada mogu se uračunati u godišnju stopu renoviranja.</p> <p>7. Do 31 Jula 2018. KAEE, u saradnji sa resornim ministarstvom nadležnim za upravljanje javnim objektima, će izraditi i staviti na raspolaganje javnosti listu objekata centralnih vlasti navedenih u stavu 2. ovog člana i isključiti objekte navedene u stavu 4. ovog člana. Ova lista će sadržavati najmanje sledeće podatke</p> <p>7.1. površinu poda u m2, i</p> <p>7.2. energetska učinak svake zgrade ili odgovarajuće energetske podatke.</p> <p>8. Ministarstvo, uz podršku KAEE i KFEE, priprema i podnosi Vladi na usvajanje podzakonske akte za tri (3) godišnji plan za renoviranje zgrada centralne vlade, koji će utvrditi najmanje:</p> <p>8.1. spisak zgrada u vlasništvu i u upotrebi centralne vlade koje će biti renovirane svake godine, glavne mere energetske efikasnosti i predviđene troškove</p>
--	---	--

<p>kostot e parashikuara të investimeve.</p> <p>8.2. aranzhimet e zbatimit për renovimin e ndërtesave duke përfshirë mundësinë për të transferuar këtë përgjegjësi tek FKKEE.</p> <p>8.3. burimet dhe metodat e financimit të investimeve përfshirë përgatitjen e projekteve, tenderimin, zbatimin e furnizimeve dhe punëve, si dhe verifikimin pas zbatimit.</p> <p>8.4. mënyrën raportimit tek AKEE mbi progresin e zbatimit të planit të renovimit.</p> <p>9. AKEE është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e një skeme për arritjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesat e renovuara.</p> <p>10. Çdo vit, deri më 31 Maj, në bashkëpunim me FKKEE, sipas nevojës, AKEE përgatit dhe dorëzon në Ministri raportin që përfshin informata mbi ndryshimet e nevojshme në planin tre (3)vjeçar të renovimit të ndërtesave të institucioneve të qeverisë qendrore, nëse kërkohet, numrin e kontratave të përfunduara gjatë vitit të kaluar, shkallën vjetore e renovimit të ndërtesave, masat e efikasitetit të energjisë dhe shpenzimet e përgjithshme të</p>	<p>investment costs.</p> <p>8.2 implementation arrangements for the renovation of buildings including the option to transfer this responsibility to KEEF.</p> <p>8.3 sources and methods of financing the investments including project preparation, tendering, implementation of supplies and works and post implementation verification;</p> <p>8.4. method of reporting to KEEA on the progress of implementation of the renovation plan.</p> <p>9. KEEA shall be responsible for the establishment and administration of a scheme to achieved of minimum energy performance requirements in renovated buildings.</p> <p>10. Annually, by 31 May, KEEA, in collaboration with KEEF as required, shall prepare and present to the Ministry report including information on necessary amendments to the three(3)year buildings renovation plan of the central government institutions,if required, the number of contracts concluded during the previous year, the annual renovation rate of buildings, energy efficiency measures and total expenditure incurred,</p>	<p>investicija.</p> <p>8.2. implementacione aranžmane za renoviranje zgrada, uključujući mogućnost prenošenja ove odgovornosti na KFEE.</p> <p>8.3. izvore i metode za finansiranje investicija, uključujući pripremu projekata, tenderisanje, izvršenja nabavki i radova, kao i verifikaciju nakon sprovođenja;</p> <p>8.4. način izveštavanja KAEE o napretku u sprovođenju plana renoviranja.</p> <p>9. KAEE će biti nadležna za uspostavljanje i upravljanje shemom do dostignutog minimuma zahteva za energetske efikasnost u obnovljenim objektima.</p> <p>10. 10. Svake godine, do 31 Maja, KAEE će u saradnji sa KFEE, po potrebi izraditi i predstaviti ministru izveštaj, uključujući informacije o neophodnim izmenama i dopunama tri (3)godišnjeg plana obnove za institucije centralnih vlasti, po potrebi, broj ugovora zaključenih tokom prethodne godine, godišnju stopu obnavljanja objekata, mere energetske efikasnosti i ukupne troškove, rezultate verifikacije i energetske uštedu</p>
--	---	--

<p>realizuar, rezultatet e verifikimit dhe kursimet e energjisë të arritura gjatë vitit të kaluar, si dhe informacione të tjera relevante. Raporti do të publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë.</p> <p>11. Qeveria e Kosovës do të inkurajojë organet e tjera publike që nuk i përkasin institucioneve qeveritare të nivelit qendror siç përcaktohet në paragrafi 1.2 të nenin 3 të këtij ligji, duke përfshirë organet rajonale dhe lokale, si dhe organet e tjera të qeverisura nga e drejta publike, që të zbatojnë planet e renovimit të ndërtesave në pronësi dhe shfrytëzim nga to, duke ndjekur rolin ekzemplar të ndërtesave të institucioneve qeveritare të nivelit qendror të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.</p>	<p>verification results and energy savings achieved over the previous year, as well as other relevant information. The report shall be published on the official websites of Ministry.</p> <p>11. The Government of Kosovo shall encourage other public bodies not belonging to the government institutions of central level, as defined in paragraph 1.2 of article 3 of this law, including regional and local level bodies, as well as other bodies governed by public law, to implement plans for renovation of buildings owned and occupied by them, following the exemplary role of the government institutions of central level, buildings, as laid down in paragraphs 1 and 2 of this article.</p>	<p>tokom prethodne godine, kao i druge relevantne informacije. Izveštaj će biti objavljen na zvaničnoj internet stranici ministarstva.</p> <p>11. Vlada Kosova će podsticati druge javne organe koji ne pripadaju institucije vlade centralnog nivoa, kao što je utvrđeno u stav 1.2 člana 3 ovog zakona, uključujući regionalne i lokalne organe, kao i druge organe koji se rukovode javnim pravom, da sprovede planove za renoviranje zgrada koje su u njihovom vlasništvu i upotrebi, prateći primernu ulogu zgrada institucije vlade centralnog nivoa utvrđene u stavovima 1 i 2 ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Blerja nga organet publike</b></p> <p>1. Autoritetet dhe organet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe të gjitha autoritetet ose subjektet tjera publike që zbatojnë Ligjin për Prokurimin Publik dhe ose FKKEE, do të blejnë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efijencës së energjisë, me kusht që ato janë në përputhje me kosto-efektivitetin, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë e përgjithshme, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme, në pajtim me Udhëzimin</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Purchasing by public bodies</b></p> <p>1. Central and local administration authorities, as well as all other public authorities or entities that apply the Law on Public Procurements and or the KEEF shall purchase only products, services and buildings with high energy-efficiency performance, insofar as that is consistent with cost-effectiveness, economic feasibility, wider sustainability, technical suitability, as well as sufficient competition, as referred to in the Administrative Instruction provided to in paragraph 1.3. article 42 of this</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Kupovina od strane javnih organa</b></p> <p>1. Autoriteti i organi centralne i lokalne uprave, kao i svi drugi javni autoriteti ili subjekti koji primenjuju Zakon o javnim nabavkama i ili KFEE, kupuju samo proizvode, usluge i zgrade sa visokim učinkom energetske efikasnosti, pod uslovom da su u skladu sa troškovnom efikasnošću, ekonomskom izvodljivošću, ukupnom održivošću, tehničkom prikladnošću, kao i sa dovoljnom konkurencijom u skladu sa Administrativnim uputstvom utvrđenim stav</p>

<p>Administrativ sipas paragrafit 1.3 të nenit nenit 42 të këtij ligji.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni aplikohet edhe për personat juridikë privatë në rast të kontraktimit të prokurimeve të punimeve, furnizimeve ose shërbimeve të financuara dhe ose të subvencionuara me së paku 50% nga fondet publike ose me mbështetje financiare të FKEE.</p> <p>3. Detyrimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet për kontratat e forcave të armatosura vetëm në atë masë që zbatimi i tij nuk shkakton konflikt me natyrën dhe qëllimin parësor të veprimtarisë së forcave të armatosura.</p> <p>4. Gjatë tenderimit të kontratave të shërbimeve me përmbajtje të konsiderueshme të energjisë, autoritetet dhe organet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të vlerësojnë mundësinë e lidhjes së kontratave afatgjata të performancës së energjisë që sigurojnë kursime afatgjata të energjisë.</p> <p>5. Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, gjatë blerjes së pakove të produkteve të mbuluara në tërësi nga një akt i deleguar i miratuar në kuadër të legjislacionit mbi etiketimin e energjisë të produkteve që lidhen me energjinë, eficientia e përgjithshme e energjisë duhet të ketë prioritet mbi eficientën</p>	<p>law.</p> <p>2. Paragraph 1 of this article shall also apply to private legal persons in the event of contracting procurements of works, supplies or services financed and or subsidized at least 50% by public funds or through KEEF financial support.</p> <p>3. The obligation defined in paragraph 1 of this article shall apply to the contracts of the armed forces only to the extent that its application does not cause any conflict with the nature and primary aim of the activities of the armed forces.</p> <p>4. When tendering service contracts with significant energy content, authorities and bodies referred to in Paragraph 1 of this article shall assess the possibility of concluding long-term energy performance contracts that provide long-term energy savings.</p> <p>5. Without prejudice to Paragraph 1 of this article, when purchasing a product package covered as a whole by a delegated act adopted under the legislation on energy labeling of energy related products, the aggregate energy efficiency shall take priority over the energy efficiency of individual products within that</p>	<p>1.3 u çlanu 42 ovog zakona.</p> <p>2. Stav 1 ovog člana primenjuje se i na privatna pravna lica u slučaju ugovaranja nabavke radova, snabdevanja ili usluga koje su finansirane i ili subvencionisane sa najmanje 50% iz javnih fondova ili uz finansijsku podršku KFEE-a.</p> <p>3. Obaveza utvrđena u stavu 1 ovog člana primenjuje se na ugovore oružanih snaga samo u meri u kojoj njena primena ne prouzrokuje sukob sa prirodom i primarnim ciljem delatnosti oružanih snaga.</p> <p>4. Prilikom tenderisanja za ugovore o uslugama sa značajnim energetske sadržajem, autoriteti i organi navedeni u stavu 1 ovog člana će proceniti mogućnost zaključivanja dugoročnih ugovora o energetske učinku kojima se osigurava dugoročna ušteda energije.</p> <p>5. Ne dovodeći u pitanje stav 1 ovog člana, pri kupovini paketa proizvoda koji je kao celina obuhvaćen delegiranim aktom donetim u okviru zakonodavstva o energetske etiketiranju proizvoda povezanih sa energijom, ukupna energetska efikasnost mora imati prednost u odnosu na energetske</p>
--	--	---



<p>e energjisë së produkteve individuale brenda asaj pakoje, duke blerë pakon e produktit që përputhet me kriterin që i përket klasës më të lartë të efijencës së energjisë.</p>	<p>package, by purchasing the product package that complies with the criterion of belonging to the highest energy efficiency class.</p>	<p>efikasnost pojedinačnih proizvoda u sklopu tog paketa, kupujući paket proizvoda koji je u skladu sa kriterijumom pripadnost najvišem razredu energetske efikasnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Skema obligative për efijencë të energjisë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Energy efficiency obligation scheme</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Obavezna šema energetske efikasnosti</b></p>
<p>1. Ministria krijon Skemën Obligative për Efijencë të Energjisë që ka për qëllim arritjen e cakut kumulativ të kursimit të energjisë siç përcaktohet në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij neni. Caku do të arrihet me kombinim të zbatimit të Masave Alternative siç përcaktohet në paragrafët 6, 7 dhe 8 të këtij neni dhe duke imponuar detyrime të kursimeve të energjisë ndaj palëve të detyruara.</p>	<p>1.The Ministry establishes Energy Efficiency Obligation Scheme aiming at achieving cumulative energy saving target as defined in to paragraphs 3, 4 and 5 of this Article.The target shall be achieved with a combination of implementation of Alternative Measures as defined in to Paragraphs 6, 7 and 8 of this Article and by imposing energy saving obligations to Obligated Parties.</p>	<p>1. Ministarstvo osniva Shemu Obavezne energetske efikasnosti u cilju postizanja kumulativnog cilja uštede energije, kao što je definisano u stavovima 3, 4. i 5. ovog člana. Cilj će biti postignut kombinacijom primene alternativnih mera definisanih u stavovima 6, 7. i 8. ovog člana i nametanjem obaveza za uštedu energije obavezanim stranama.</p>
